



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 609/1 prot.

Shkodër, më 10.09.2021

Nr. 5146/1 Prot

Dt. 13.09.2021



LËNDA: Mbi vendimin Nr.51 datë 26.08.2021 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 24, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin Social”, neni 15, materialit të dërguar nga sekretari i këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.5144.prot, datë 1.09.2021 mbi dokumentacionin shoqërues të mbledhjes së këshillit bashkiak Vau-Dejës të datës 26.08.2021”, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës nr.51 datë 26.08.2021 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “Subvencionimit të qerasë, në tregun e lirë”.**


Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Në vemendje respektimi i nenit 12 të Ligjit Nr.7748 dt.29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe përndjekurve politike nga sistemi komunist” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 81 datë 26.08.2021

“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “ Subvencionimit të qiras, ne tregun e lire” i hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr 42 datë 28.06.2021.

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma “n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social”, neni 15 dhe neni 16, me propozimin e Komisionit të Strehimit i ngritur me VKB nr 42 datë 28.06.2021:

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI**

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit , i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit të “Subvencionimit të qiras, ne tregun e lire”, **bashkëlidhur** .
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”

KRYETAR
Mark BISHA

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me Datë 01.09.2021